



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

Numri i lëndës: 2023:285747  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05723850

K.DH.SH.II nr.580/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Banka për Biznes (BPB), me seli ne rr.”Ukshin Hoti” nr.128 ne Prishtinë, kundër debitorëve 1. DPZ “Auto Xhama Kristal” me nr. Biznesi 70223110 me seli ne rr.” Edit Durham” nr.16 ne Fushë Kosovë, përfaqësuar nga A.A. me nr. Personal ... me adresë ne rr.” ... ne Fushë Kosovë-kredi marrës, 2. R.A. me nr. Personal ... me adresë rr. “...ne Fushë Kosovë-bashkëkredimarrës, 3. H.A. me nr. Personal ... me adresë rr. “...ne Fushë Kosovë-bashkëkredimarrës, me bazë përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit DPZ “Auto Xhama Kristal” me nr. Biznesi 70223110 me seli ne rr.” ...ne Fushë Kosovë, përfaqësuar nga A.A. me nr. Personal ... me adresë ne rr.” ...ne Fushë Kosovë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.62/23 dt.27.12.2023, me datë 22.05.2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit DPZ “Auto Xhama Kristal” me nr. Biznesi 70223110 me seli ne rr.” Edit Durham” nr.16 ne Fushë Kosovë, përfaqësuar nga A.A. me nr. Personal ... me adresë ne rr.” ...ne Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.62/23 dt.27.12.2023, VËRTETOHET.

#### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 62/23 dt.27.12.2023, ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit DPZ “Auto Xhama Kristal” me nr. Biznesi 70223110 me seli ne rr.” ...” nr.... ne Fushë Kosovë, përfaqësuar nga A.A. me nr. Personal ... me adresë ne rr.” ...ne Fushë Kosovë, të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.635/22 dt.16.12.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ka ushtruar ankesë debitori DPZ “Auto Xhama Kristal” me nr. Biznesi 70223110 me seli ne rr.” ...” nr.... ne Fushë Kosovë, përfaqësuar nga A.A. me nr. Personal ... me adresë ne rr.” ...ne Fushë Kosovë, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkalles se dytë, këtë ankesë ta aprovoj si te bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta prish ashtu qe lënda te kthehet ne rivendosje.

Përgjigje ndaj ankesës e debitorit ka ushtruar kreditori , me te cilin kërkon qe gjykata e shkalles se dytë ta refuzoj si te pabazë ankesën e debitorit ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Banka për Biznes (BPB) , me seli ne rr.” Ukshin Hoti” nr.128 ne Prishtinë, me datën 15.12.2022, ndaj debitorëve 1. DPZ “Auto Xhama Kristal” me nr. Biznesi 70223110 me seli ne rr.” ...” nr.1... ne Fushë Kosovë, përfaqësuar nga A.A. me nr. Personal ... me adresë ne rr.” ...ne Fushë Kosovë-kredi marrës, 2. R.A. me nr. Personal ... me adresë rr. “...ne Fushë Kosovë-bashkëkredimarrës, 3. H.A. me nr. Personal ... me adresë rr. “...ne Fushë Kosovë-bashkëkredimarrës, në bazë të dokumentit te përmbartimor Marrëveshje Bashkëpunimi dhe përkrahje Financiare nr.83/2018 Fushë Kosovë, Aneks Kontrata për Kredi te Biznesit nr.K0018/4126 dt.07.06.2018, Kontrate mbi Krijimin e Hipotekës LRP.nr.6098/2018 ref.nr.1889/2018 dt.08.06.2018, Aktvendim mbi Regjistrimin e Hipotekës nbr.prot.130/2018 lëshuar nga Zyra Kadastrale ne Fushë Kosovë, Marrëveshje Kolaterali mbi Pengun e luajtshëm nr. K0018/4126 dt.07.06.2018, Konfirmim regjistrimi R-20180612-155 dt.12.06.2018 deri me 12.06.2023, lëshuar nga Zyra për Regjistrim te Pengut pranë Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë. Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj nga Prishtina, sipas propozimit për përmbartim, me urdhrin përmbartimor P.nr.635/22 dt.156.12.2022, ka lejuar përmbartimin me te cilin ka obliguar debitorin qe kreditorit t’ia paguaj detyrimin sipas këtyre marrëveshjeve dhe atë ne shumën prej 22,230.33 euro si dhe shpenzimet e procedurës.

Ndaj urdhrin përmbartimor, debitori DPZ “Auto Xhama Kristal” me datën 05.01.2023, ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se propozimi për përmbartim është i parregullt sepse nuk përmban elementet thelbësore përkatësisht precizimin e saktë te kërkesës se kredisë, kreditori nuk i ka bashkangjitur propozimit kontratën kryesore te kredisë por vetëm anekset/shtojcat, shton se edhe pengu i paraqitur ne propozim është i pa ekzekutueshëm pasi nuk mund te regjistrohet peng sendi i pa identifikueshëm dhe pa numër serik. Propozon qe gjykata ta konsideroj prapësimin te bazuar ndërsa urdhrin përmbartimor ta prish apo ta anuloj si dhe propozimi për përmbartim te hedhet poshtë.

Përgjigje ndaj prapësimit të debitorit ka ushtruar kreditori me datën 10.01.2023, me arsyetimin se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, e po ashtu debitori prapësimin ka paraqitur jashtë afatit pasi nuk është respektuar afatet ligjore nga neni 70 të LPP, qëllimi i prapësimit është vetëm i kësaj nga obligimet kreditore andaj propozon që gjykata ta hedh poshtë prapësimin si të paafatshëm ndërsa urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të prapësimit dhe shkresave në lëndë, ka nxjerr aktvendimin KPPP nr. 62/23 dt.27.12.2023, përmes së cilit e ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit DPZ “Auto Xhama Kristal” duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Arsyeton se konform nenit 70 të LPP konsideron se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm sepse debitori urdhrin përmbartimor e ka pranuar me datën 28.12.2022 ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedh nga data 29.12.2023 nga rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 04.01.2023. Andaj meqë debitori e ka paraqitur prapësimin me datën 05.01.2023 që vërtetohet dhe nga vula e pranimit të Përmbartuesit Privat protokolluar me nr.653/2023 ndërsa nga shkresat e lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, ashtu që konform nenit 73 par.3 të LPP ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 e as neni 183 të LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Në vlerësim të çështjes në raport me provat e lëndës, kjo gjykatë vlerëson se neni 70 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcakton që: *“Prapësimi duhet të dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”*, ndërsa me dispozitivin e nenit 73 paragrafi 3, parashihet së: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i paafatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*.

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, sepse nga fletë kthesa për dorëzim personal e cila gjendet në shkresat e lëndës konstatohet se debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.635/22 dt.16.12.2022 e ka pranuar me datë 29.10.2014, ndërsa prapësimin ndaj këtij urdhri e ka paraqitur me datën 05.01.2023, rezulton se debitori nuk ka vepruar brenda afatit ligjor për paraqitjen e prapësimit. Andaj meqë në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë nga e cila vërtetohet se prapësimi është dorëzuar në ndonjë mënyrë tjetër rezulton se i njëjti është i pasafatshëm prandaj edhe është hedhur si i tillë.

Kjo gjykatë i ka analizuar pretendimet ankimore te debitorit, mirëpo te njëjtat i ka vlerësuar si jo relevante për një vendosjeje ndryshe nga ajo çka ka vendosur gjykata e shkalles se parë, prandaj te njëjtat i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.580/24, me datë 22.05.2024

Gjyqtari  
Ramush Bardiqi